6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	100,00	100,00	100,00
6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	100,00	100,00	100,00
7.1.1	Territori i komunës i rregulluar sipas planeve hapësinore komunale	100,00	100,00	100,00
7.2.1	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	84,68	84,68	84,68
7.2.2	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	100,00	100,00	100,00
8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m <sup>2</sup> për kokë banori	100,00	100,00	100,00
8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	88,20	88,20	88,20
8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	100,00	100,00	100,00
9.1.1	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	79,83	79,83	79,83
9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	89,04	89,04	89,04



9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	13,82	13,82	13,82
9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	19,11	19,11	19,11
9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjzime vertikale dhe horizontale	59,87	59,87	59,87
9.2.4	Rrugët me shteg të biçikletave	2,18	2,18	2,18
9.2.5	Rrugë lokale të riasfaltuara	100,00	100,00	100,00
10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	88,89	0,00	0,00
10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	80,00	80,00	80,00
10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	70,83	70,83	70,83
11.1.1	Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e ujësjellësit	100,00	100,00	100,00
11.1.2	Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e kanalizimit	100,00	100,00	100,00
11.1.3	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	100,00	100,00	100,00
11.1.4	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	99,10	99,10	99,10
11.1.5	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	93,39	93,39	93,39
12.1.1	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	100,00	0,00	0,00
12.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	100,00	100,00	100,00
12.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	100,00	100,00	100,00
13.1.1	Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale	100,00	100,00	100,00
13.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	91,67	91,67	91,67
13.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	52,63	52,63	52,63
13.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	100,00	100,00	100,00
13.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	0,00	0,00	0,00
13.2.1	Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	100,00	100,00	100,00
13.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	86,40	86,40	86,40
13.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	62,17	62,17	62,17
13.2.4	Realizimi i planit komunal për barazi gjinore	100,00	100,00	100,00
13.3.1	Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	1,85	1,85	1,85
13.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	20,79	20,79	20,79
14.1.1	Shkolla me masa të efikasitetit të energjisë	52,59	52,59	52,59
14.1.2	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	100,00	100,00	100,00
14.1.3	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	59,09	59,09	59,09
14.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	63,40	63,40	63,40
14.3.1	Fëmijë që vijnë në kopshtin	20,47	20,47	20,47
14.3.2	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	43,10	43,10	43,10
14.3.3	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	85,39	85,39	85,39
14.3.4	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	99,77	99,77	99,77
14.3.5	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	98,34	98,34	98,34
14.4.1	Trajtimi i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga komisioni i DKA	100,00	100,00	100,00
14.4.2	Shkalla e sigurimit të mbështetjes me pedagog - asistent ndihmës për fëmijët / nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta	100,00	100,00	100,00
15.1.1	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	62,97	62,97	62,97
15.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	81,51	58,96	58,96
15.3.1	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	96,79	96,79	96,79
15.3.2	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gratë dhe fëmijë	100,00	100,00	100,00
16.1.1	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	100,00	100,00	100,00
16.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	100,00	100,00	100,00
16.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në pronë	100,00	100,00	100,00
16.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	54,97	0,00	0,00
<b>Mesatarja</b>		<b>82,28</b>	<b>77,24</b>	<b>78,82</b>



## Konkluzione dhe rekomandime

Një nga prioritetet kryesore nga ky raport është forcimi i sistemit të raportimit dhe verifikimit të të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). Për këtë arsye, rekomandohet që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të organizojë trajnime shtesë për koordinatorët, zyrtarë komunalë të performancës dhe nje administrim më efikas nga drejtoritë komunale, me qëllim që të sigurohet një kuptim i plotë i procedurave të raportimit dhe shmangies së të dhënave të pavlefshme. Po ashtu, është e nevojshme të hartohen udhëzime të standardizuara për dokumentimin e të dhënave dhe të krijohen mekanizma për konsultime paraprake me komunitetin, në mënyrë që të garantohet cilësia e raportimit para finalizimit të rezultateve. Një tjetër element thelbësor është nxitja e qeverisjes së mirë. Komunitetet duhet të angazhohen në zbatimin e plotë të standardeve minimale të konsultimit publik, duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset buxhetore dhe në hartimin e planeve zhvillimore do të kontribuojë drejtpërdrejt në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës.

Përveç kësaj, rekomandohet që komunitetet të rrisin efikasitetin në përdorimin e fondeve publike. Ky qëllim mund të arrihet duke fokusuar investimet në projekte kapitale që adresojnë boshllëqet më të theksuara strukturore, si transporti publik, infrastruktura rrugore apo ndërtimi i çerdheve dhe shkollave të reja. Njëkohësisht, duhet përmirësuar zbatimi i planit të prokurimit dhe mbikëqyrja e kontratave për të siguruar që fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efektive.

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2024 nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal:

Në fushën e **shërbimeve publike administrative**, rekomandohet që komunitetet të zgjerojnë më tej ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, duke i bërë ato të qasshme në mënyrë online. Thjeshtimi i procedurave administrative mbetet një domosdoshmëri për të zvogëluar barrën burokratike, ndërsa vendosja e standardeve të njëjta për kohën e trajtimit të kërkesave do të sigurojë një qasje më të barabartë dhe efikase në të gjitha komunitetet.

Në fushën e **transparencës komunale**, është e domosdoshme të sigurohet publikimi i të gjitha dokumenteve kryesore si buxhetet, planet komunale dhe vendimet e kuvendit, në format të hapur dhe të lehtë për t'u lexuar nga qytetarët. Transmetimi online i seancave të kuvendeve komunale duhet të bëhet praktikë e detyrueshme, ndërsa raportet periodike mbi proceset e konsultimeve publike duhet të publikohen rregullisht, duke dëshmuar ndikimin e qytetarëve në vendimmarrje.

Sa i përket **përgjegjshmërisë komunale**, rekomandohet rritja e përqindjes së qytetarëve që marrin pjesë në konsultimet publike, në përputhje me standardin e SMPK-së. Funkcionalizimi i këshillave lokalë duhet të trajtohet si prioritet, pasi ato janë mekanizma të rëndësishëm të demokracisë vendore. Gjithashtu, komunitetet duhet të përmirësojnë nivelin e adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili aktualisht mbetet i ulët. Monitorimi i pagesave brenda afateve ligjore është gjithashtu i nevojshëm për të shmangur vonesat dhe për të rritur efikasitetin financiar.

Në fushën e **barazisë në punësim dhe shërbimeve sociale**, është e nevojshme që komunitetet të zbatojnë realisht kuotat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë mbështetje për komunitetet joshumicë. Investimet në banimin social dhe përkujdesja për familjet në nevojë duhet të forcohen, ndërsa fëmijët që kanë nevojë për strehim duhet të kenë mbështetje të garantuar përmes programeve të dedikuara.

Fusha e **kulturës, rinisë dhe sportit** ka treguar rezultate të mira, por rekomandohet që komunitetet të sigurojnë financim të qëndrueshëm për organizatat kulturore lokale dhe të nxisin partneritete me



sektorin privat për të përmirësuar ofertën e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Për më tepër, duhet të krijohen hapësira të reja sportive dhe kulturore, duke iu dhënë prioritet zonave që kanë mungesa të theksuara.

Në fushën e **menaxhimit të fatkeqësive**, komunat duhet të hartojnë dhe zbatojnë plane të mirëfillta për reagim emergjent, pasi aktualisht niveli i realizimit mbetet i ulët. Trajnimet për stafin komunal mbi menaxhimin e rreziqeve dhe fuqizimi i koordinimit ndërkomunal për ndërhyrje të shpejta janë hapa të domosdoshëm për të rritur sigurinë e qytetarëve.

Sa i përket **planifikimit hapësinor**, rekomandohet rritja e mbulimit të territorit të komunave me plane rregulluese të hollësishme, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin urban dhe rural të qëndrueshëm. Kontrolli i rreptë i ndërtimeve të reja për respektimin e lejeve ndërtimore duhet të jetë prioritet, ndërsa integrimi i planifikimit hapësinor me strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal do të sigurojë zhvillim të balancuar.

Në fushën e **hapësirave publike**, komunat duhet të punojnë në rritjen e sipërfaqeve të gjelbra për kokë banori dhe të sigurojnë mirëmbajtje të rregullt të parqeve dhe ndriçimit publik. Investimet në hapësira rekreative dhe shëtitore janë të rëndësishme për të rritur cilësinë e jetesës së qytetarëve, sidomos në zonat urbane të mbipoplluara.

Sa i përket **infrastrukturës rrugore**, rekomandohet orientimi i investimeve drejt ndërtimit të trotuareve, shtigjeve për biçikleta dhe përmirësimit të ndriçimit publik, që aktualisht mbeten të mangëta. Riasfaltimi i rregullt i rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e tyre gjatë stinëve janë po ashtu të domosdoshme. Një fokus i veçantë duhet të jetë vendosja e shenjzimit horizontal dhe vertikal në të gjitha rrugët lokale për të rritur sigurinë në trafik.

Në fushën e **transportit publik**, komunat duhet të hartojnë dhe zbatojnë plane të mobilitetit lokal, të zgjerojnë rrjetin e transportit publik për të përfshirë më shumë vendbanime dhe të vendosin infrastrukturë të përshtatshme për stacionet dhe ndalesat e transportit. Kjo do të përmirësonte ndjeshëm qasjen e qytetarëve në shërbimet komunale dhe do të ndikonte në uljen e trafikut privat.

Në fushën e **shërbimeve publike**, përfshirë ujin, kanalizimin dhe menaxhimin e mbeturinave, komunat duhet të përfundojnë projektet e ujësjellësit dhe kanalizimit, sidomos në zonat rurale. Përmirësimi i sistemit të inkasimit të pagesave për shërbimin e mbeturinave dhe përdorimi i teknologjive moderne për riciklim dhe menaxhim të qëndrueshëm të tyre janë hapa që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

Në fushën e **mbrojtjes së mjedisit**, rekomandohet hartimi dhe zbatimi i planeve lokale për mjedisin, pasi aktualisht ato janë realizuar vetëm në një shkallë shumë të ulët. Monitorimi i vazhdueshëm i ndërtimeve për respektimin e lejeve mjedisore duhet të forcohet, ndërsa ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm.

Sa i përket **përfaqësimit gjinor**, komunat duhet të rrisin numrin e grave në pozita vendimmarrëse në administratë dhe të mbështesin programet që promovojnë barazinë gjinore në nivel lokal. Fushatat vetëdijësuese për rolin e grave në politikën vendore janë të domosdoshme për të rritur përfshirjen e tyre aktive.

Në fushën e **arsimit parauniversitar**, rekomandohet zgjerimi i rrjetit të çerdheve dhe shkollave, sidomos në zonat rurale, për të siguruar qasje më të barabartë në arsim. Përmirësimi i kushteve teknike dhe higjienike në shkolla, digjitalizimi i tyre dhe pajisja me mjete bashkëkohore mësimore janë investime që duhet të jenë prioritet. Një fokus i veçantë duhet të jetë reduktimi i mbingarkesës në klasa, që mund të arrihet përmes ndërtimit të objekteve të reja shkollore.



Në fushën e **kujdesit parësor shëndetësor**, komunat duhet të investojnë në ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, përfshirë ndërtimin e qendrave të reja të mjekësisë familjare dhe furnizimin me pajisje moderne. Rritja e numrit të personelit shëndetësor në nivel komunal është e domosdoshme, ndërsa duhet të hartohen plane të veçanta për ofrimin e kujdesit shëndetësor në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara.

Në fund, në **fushën e zhvillimit ekonomik lokal**, rekomandohet hartimi i strategjive të qarta për të tërhequr investime private, krijimi i zonave ekonomike dhe mbështetja për ndërmarrjet e vogla e të mesme. Përfshirja e komunave në projekte të partneritetit publik-privat do të mundësonte zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.





Republika e Kosovës-Komuna e Istogut  
Republika Kosovo-Opština Istok  
Republic of Kosovo-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01.Nr. 217 /2026

Datë: 13.03.2026

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008, nenin 8 të Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/10 të datës 30.11.2010 i :

**Propozon**

Kuvendi i Komunës në kuptim të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika d), nenit 14, paragrafi 14.1 nenit 17 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale , nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien ne Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019, nenit 6, paragrafi 1.2 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe neni 83, paragrafi 83.1 dhe 83.2 të Statutit 01.Nr.62/2010 të Komunës së Istogut lidhur me publikimin e Listës së Përgjithshme, dhe Listës se Veçantë të Pronave të Paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim, në mbledhjen e planifikuar për tu mbajtur me datë 30.03.2026 të miratojë këtë :

**V E N D I M**

**PËR MIRATIM PARAPRAK TË LISTES SË PËRGJITHSHME SI, DHE LISTES SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM PËR VITIN 2026**

**1. MIRATOHET** - Lista e Përgjithshme, dhe Lista e Veçante e Pronave të Paluajtshme të Komunës së Istogut qe planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

2.Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Lista e Përgjithshme dhe Lista e Veçante e pronave të paluajtshme të Komunës së Istogut për Dhënien në Shfrytëzim për vitin 2026, duke përfshirë: certifikatën e pronës , kopjen e planit dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për secilën pronë.

3.Procedura e Dhënies në Shfrytëzim të Pronave të Paluajtshme do të jetë në harmoni të plotë me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien ne Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019 si dhe Rregulloren QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4.Dhënia në shfrytëzim e pronave komunale qe parashihen te jepen në shfrytëzim gjatë vitit (2026) ka për qëllim, zhvillimin ekonomik, si dhe rritjen e vlerës të pronave të paluajtshme të Komunës me qëllim të realizimit dhe ngritjes së të hyrave vetanake.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të Ligjit dhe Rregullores për dhënien ne Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme te Komunës, obligohet qe te përkuqdeset: Komisioni Vlerësues, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Departamenti për çështje Pronësore.

6.Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në (web) faqen zyrtare të Komunës, në kuptim të dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.



Kryetari i Komunës:  
Z. Ilir BEKATI



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo



**Komuna e Istogut**

Opstina Istok

Municipality Istog

**Lista e Veçantë e Pronave Komunale qe planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit (2026)**

Nr.	Ngastra Kadastrale	Sipërfaqja e përgjithshme m2	Sipërfaqja e planifikuar për dhënie në shfrytëzim m2	Zona Kadastrale	Pronari (Poseduesi)
1	P-70806044-00211-6	1200	1200	Sinajë	Komuna e Istogut
2	P-70806044-00211-8	5613	5613	Sinajë	Komuna e Istogut
3	P-70806044-00211-9	5423	5423	Sinajë	Komuna e Istogut
4	P-70806044-00730-0	6595	6595	Sinajë	Komuna e Istogut
5	P-70806044-00728-0	11586	11586	Sinajë	Komuna e Istogut
6	P-70806044-00733-0	2666	2666	Sinajë	Komuna e Istogut
7	P-70806044-00905-0	33879	33879	Sinajë	Komuna e Istogut

8	P-70806044-00749-1	11102	11102	Sinajë	Komuna e Istogut
9	P-70806013-00960-0	3436	3436	Dobrushë	Komuna e Istogut
10	P-70806013-01011-1	1523	1523	Dobrushë	Komuna e Istogut
11	P-70806013-01013-0	3290	3290	Dobrushë	Komuna e Istogut
12	P-70806013-01012-0	4283	4283	Dobrushë	Komuna e Istogut
13	P-70806013-01014-1	2275	2275	Dobrushë	Komuna e Istogut
14	P-70806013-01014-2	4899	4899	Dobrushë	Komuna e Istogut
15	P-70806013-01014-3	6446	6446	Dobrushë	Komuna e Istogut
16	P-70806013-01014-4	7222	7222	Dobrushë	Komuna e Istogut
17	P-70806053-00397-0	46645	46645	Tuçep	Komuna e Istogut
18	P-70806048-00305-0	10767	10767	Llukac i Thatë	Komuna e Istogut
19	P-70806048-00306-1	5704	5704	Llukac i Thatë	Komuna e Istogut
20	P-70806048-00307-0	8437	8437	Llukac i Thatë	Komuna e Istogut
21	P-70806037-00942-0	931959	931959	Osojan	Komuna e Istogut
22	P-70806037-00981-0	227706	227706	Osojan	Komuna e Istogut
23	P-70806037-00017-1	58106	58106	Osojan	Komuna e Istogut

24	P-70806037-00026-2	75604	75604	Osojan	Komuna e Istogut
25	P-70806037-00012-0	62868	62868	Osojan	Komuna e Istogut
26	P-70806037-0001-0	35625	35625	Osojan	Komuna e Istogut
27	P-70806050-01431-0	128533	128533	Shushicë	Komuna e Istogut
28	P-70806050-01429-0	91225	91225	Shushicë	Komuna e Istogut
29	P-70806050-01362-1	70940	70940	Shushicë	Komuna e Istogut
30	P-70806050-01434-0	35217	35217	Shushicë	Komuna e Istogut
31	P-70806050-01437-0	137351	137351	Shushicë	Komuna e Istogut
32	P-70806050-01270-1	43025	43025	Shushicë	Komuna e Istogut
33	P-70806050-01270-2	545	545	Shushicë	Komuna e Istogut
34	P-70806050-01425-0	324290	324290	Shushicë	Komuna e Istogut
35	P-70806050-01427-0	28500	28500	Shushicë	Komuna e Istogut
36	P-70806049-00714-1	36107	1500	Suhogerllë	Komuna e Istogut
37	P-70806049-00652-1	76252	1800	Suhogerllë	Komuna e Istogut
38	P-70806014-0099-11	19341	19341	Dubravë	Komuna e Istogut
39	P-70806014-0099-12	6570	6570	Dubravë	Komuna e Istogut
40	P-70806014-0099-14	12100	12100	Dubravë	Komuna e Istogut

41	P-70806056-00223-1	16140	12000	Carrallukë	Komuna e Istogut
42	P-70806017-00952-0	64905	64905	Zallq	Komuna e Istogut
43	P-70806017-00198-4	3228	3228	Zallq	Komuna e Istogut
44	P-70806017-00679-2	1394	1394	Zallq	Komuna e Istogut
45	O-70806020-31-2-4-0	75	75	Istog	Komuna e Istogut
46	P-70806020-00487-3	536	536	Istog	Komuna e Istogut
47	P-70806033-00216-0	37007	37007	Dubovë e Vogel	Komuna e Istogut
48	P-70806037-00172-1	133342	133342	Rakosh	Komuna e Istogut
49	P-70806037-00262-6	20731	20731	Rakosh	Komuna e Istogut
50	P-70806037-00262-5	5026	5026	Rakosh	Komuna e Istogut
51	P-70806037-00031-19	21026	21026	Rakosh	Komuna e Istogut
52	P-70806003-00251-1	291518	291518	Bellopojë	Komuna e Istogut
53	P-70806003-00249-0	23771	23771	Bellopojë	Komuna e Istogut
54	P-70806003-00501-2	104576	104576	Bellopojë	Komuna e Istogut
55	P-70806034-00152-0	108824	108824	Mojstir	Komuna e Istogut
56	P-70806016-01186-0	472274	472274	Gjurakoc	Komuna e Istogut

57	P-70806007-00541-0	123813	123813	Veriq	Komuna e Istogut
58	P-70806007-00481-5	17335	17335	Veriq	Komuna e Istogut
59	P-708060007-0546-0	19520	19520	Veriq	Komuna e Istogut

Anëtarët e Komisionit për përpilimin e listës së veçante të Pronave të Paluajtshme të Komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2026:

**Genc Ademaj, Drejtor për Zhvillim dhe Ekonomi**

\_\_\_\_\_

**Agon Dreshaj, Drejtor për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi**

\_\_\_\_\_

**Kushtrim Buleshkaj, Drejtor për Planifikim Urban dhe Mjedis**

\_\_\_\_\_

**Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Inspektionit**

\_\_\_\_\_

**Valbone Kaliqanaj, Zyrtare e Lartë e Pemëtarisë.**

\_\_\_\_\_





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosova



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality

02.Nr.64/ 2025	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje Mekanizmi Ndërinstitucional Kundër Dhunës në Familje
Data e mbajtjes:	08.12.2025 0ra: 10:00
Vendi i takimit:	Hotel TROFTA Istog
Mbledhjen e kryesoi:	Koordinatorja e MKKDHF Zyrtare për barazi gjinore
Procesmbajtës:	Servete Haxhijaj Zyrtare për Barazi Gjinore dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe koordinatorë e Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës ne Familje
Në mbledhje ishin prezent	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Enver Gashi komandant i policisë;</li><li>2. Fadil Hoxha, zyrtar policor në Istog;</li><li>3. Haki Ibrahimimi Qendra për punë Sociale</li><li>4. Servete Haxhijaj Zyrtare për Barazi gjinore.</li><li>5. Nysret Pepaj Qendra për shëndet Mendor Pejë.</li><li>6. Merita Bytyçi Drejtoria për Mirëqenie Sociale</li><li>7. Demë Hasanaj Mbrojtës i Viktimave ,Pejë.</li><li>8. Naim Behlulaj Drejtor i Arsimit</li><li>9. Argjira Pukaj Zyra komunale për Punësim.</li><li>10. Tringa Dreshaj përfaqësuese e OSBE-së</li><li>11. Drita Hakaj Sherbimi Sprovuesë.</li><li>12. Pranvera Zeqiraj Ndihm Juridike Falas</li></ol>
Mungojnë	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ilir Ferati Kryetar i komunës</li><li>2. Shemsedin Haxhijaj kryetar i gjykatës dega ne Istog</li><li>2. Mujë Osmanaj Qendra e mjekësisë Familjare</li><li>3. Zenel Shatri Drejtoria Komunale për Shëndetësi.</li><li>4. Rasim Mahmutoviq Zyra Komunale Komunitete dhe Kthim.</li><li>5. Vlora Vuthi Drejtoresh për Kulturë rini e sport</li><li>6. Arlinda Nallbani Gacafferri Prokurore</li></ol>

Me kuadër të 16 ditë të aktinizëm Kundër Dhunës në Familje, u mbajt mbledhja e tret e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në familje.

Për këtë mbledhje ishin 4 pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Njoftim për rastet e dhunës në familje për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025
3. Fuqizimi, dhe numri i rasteve të trajtuara i viktimave të dhunës në familje.
4. Diskutim i hapur.

Mbledhjen e kryesoj koordinatorja e Mekanizmit znj. Servete Haxhijaj, në fillim i përshëndeti të pranishmit në takim dhe ju uroj mirë se ardhje, pika e parë e rendit të ditës kaloi pa ndonjë vërejtje.

Pika e dytë

Njoftim me rastet e dhunës në familje fjalë i kaloi komandantit të policisë,

z. Enver Gashi, pasi i përshëndeti të pranishmit fjalën ja kaloi zyrtarit policor Fadil Hoxha për të na informuar me numrin e rasteve të raportuara në stacionin policor në Istog.

z. Hoxhaj i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi për numrin e rasteve të Dhunës në Familje të cilët kanë kërkuar ndihmë në periudhën e dytë të vitit 2025, dhe e shtoi si shqetësim që numri i rasteve të dhunës në familje është më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

U diskutua edhe për një vajzë e cila është raste recidivist ku e bën rritjen e rasteve të dhunës në familje dhe është shqetësim për qytetaret ku mendohet se abuzohet me të.

Zyrtari policor e prezantoi raportin në mënyrë të detajuar të rasteve të paraqitura në stacionin policor ku numri i rasteve të dhunës në familje ishte 60 të gjitha rastet janë në procedurë në prokurori.

Dhune fizike 29

Dhune psikologjike 21

Viktimat sipas gjinisë 56 femra edhe 14 meshkuj.

Viktima sipas moshës 10 raste nën moshën 18 vjeçare kurse tek moshën e tretë është 1 raste.

Me pas fjalën e mori edhe drejtori i qendrës për punë sociale z. Haki Ibrahimaj,

Institucioni i qendrës për punë sociale në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenien Sociale të komunës së Istogut gjegjësisht sektori i shërbimeve sociale ka ofruar shërbime për qytetare të

kategorive te ndryshme, drejtpërdrejt si dhe me aktivitete te shumta duke bashkëpunuar me te gjitha e institucionet, te cilat e kanë objektiv mirëqenien e fëmijëve, te rriturve dhe te moshuarve.

Përgjatë 6 mujorit te dyte te vitit 2025 kemi pasur disa raste te dhunës ne familje për te cilat kemi ofruar shërbime te ndryshme, ne jemi gjithmonë ne dispozicion , duke përfshirë edhe organi i kujdestarisë i cili është 24 ore nen shërbimin e qytetarëve ne nevojë.

Gjate 6 mujorit te dyte vitit 2025 kemi pasur 20 raste te dhunës ne familje

9 nga këto raste pas dhunës, janë rikthyer përsëri ne familje tek bashkëshorti

5 raste janë ndarë ,nuk janë kthyer ne familje

4 nga këto janë dhune ne familje, konflikte familjare (Motër- vëlla) (baba-fëmije) te cilët kanë përfundoi me pajtime

2 nga këto raste janë shtetas kosovar me vendqëndrim jashtë vendit.

Pranvera Zeqiraj ,Zyrtare për ndihem juridike falës tha se gjate kësaj periudhe nuk kam pas as një raste për te marr ndihmë juridike falas.

Drita Hadergjonaj zyrtare e shërbimit provues tha se gjate kësaj periudhe i kemi pas 8 raste dënime me kusht, ku 4 janë liruar, ne disa raste klasifikimi procedural e ndërron temën ku nuk e vlerëson si dhune ne familje por me pas ai rast rasti trajtohet si rast i dhunës ne familje.

Nysret Pepaj mjek i shëndetit mendor tha se ne merremi me persona me çrregullime mendore tri raste te këtilla te dhunës ne familje ku kemi një bashkëpunim te mire me shërbimin Sprovues dhe dua te ceku se puna tek ne behet ne mënyrën me te mire, ku unë i mbuloj 5 komuna dhe i kem edhe te gjitha rastet e burgut te Dubravë.

Po ashtu e ceku qe për rastet e dhunës ne familje nga mosha 14 e deri ne moshën 16 kosto e dënimit te jetë me e lart.

Po ashtu doktori tha se personave qe janë konsumues te alkoolit qe ushtrojnë dhune ne familje tha te ju ndalet asistenca sociale ose te ju jepet me periudha nga pak.

Zyrtarja e zyrës për punësim Argjira Pukaj tha se ne si zyre nuk kemi pas raste te dhunës ne familje qe ka kërkuar qe te punësohet përmes zyrës tone.

Dem Hasana zyrtar për mbrojtjen e viktimës tha:ne gjate këtij viti kemi organizuar trajnime neper shkolla dhe jemi te gatshëm te bashkëpunojmë me institucionet tjera si mekanizëm kundër dhunës ne familje, dhe te merren persona kompetent qe merren dhe e njohin natynë e këtyre rasteve.

Dem Hasanaj tha së për rastet e dhunës ne familje për gjininë mashkullore problem është qendrat strehimore ku djemtë nuk mund te gjëdrojnë ne strehimore mbi moshën 12 vjeqare.dhe me pas jetë ne mëshirën e fatit.

Po ashtu gjate këtij takimi u diskutua edhe për trajtimin dhe fuqizimin e rasteve te dhunës ne familje ,dhe u tha se rastet një here duhet te trajtohen ne mënyrë te drejt e me pas te behet edhe fuqizimi i tyre ne mënyra te ndryshme

Rekomandim:

- 1.Te behet një takim me Mekanizmin Kundër Dhunës ne Familje dhe institucioneve te tjera dhe te shikojmë cilat tema ligjërohen neper shkolla dhe cila është grup moshë e fëmijëve qe ju përgjigjet tema.
- 2.Te caktohen qendra për strehimin e personave qe ushtron dhune ne familje dhe me pas mbesin si viktima.

*Proces mbajtëse*

*Znj.Servete Haxhijaj*

*Kryetari i Komunës*

*z.Illir Ferati*





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



**Komuna e Istogut**  
Opština Istok  
Municipality

**RAPORT :NR.70/25**

**Data:29.12.2025**

**Raporti vjetor I Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës ne Familje**

# **Raport**

## **Mekanizmi Komunal Kundër Dhunës në Familje**

**2025**

## **Raport – Mekanizmi Komunal Kundër Dhunës në Familje**


- Në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2023-2027 është themeluar Mekanizmi Komunal kundër Dhunës në familje me datë 08.12.2023.
- Gjatë këtij viti janë mbajtur 4 takime të cilat janë obligative, nga katër takime në një vite kalendarikë.
- Pjesëmarrës në mbledhjet e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje janë 18 anëtar nga institucionet të cilat janë të parapara në Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje dhe dhunës ndaj grave .

## **Takimi i Parë i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje**

- Për mbledhjen e parë të MKKDDHF ish-in paraparë 3 pika të rendit të ditës.
- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- Njoftim për rastet e dhunës në familje për tre (3) mujorin e parë të vitit 2025;
- Diskutim i hapur;

- Mbledhjen e kryesoj nënkryetari i komunës z. Ali Nimanaj  
Për pikën e parë të rëndit të ditës fjala ju dha të gjithë të pranishmeve
- Ky takim shërbej si platforme për koordinimin dhe shkëmbimin e përvojave për funksionimin dhe forcimin e veprimit të përbashkët në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke vendosur hapa konkret për veprimet e ardhshme.
- Komuna e Istogut mbetet e përkushtuar në krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetaret në fokus të veçante në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe fuqizim mekanizmale ekzistues për trajtimin e rasteve.







## **Takimi i Dytë i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje**

- Me datën 01.07.2025 për këtë mbledhje ishin propozua 5 pika të rendit të ditës .
- Pas miratimit të pikes së parë u diskutua për pikën e dytë të rendit të ditës, të pranishmit u njoftuan për rastet e dhunës në familje në 6 mujorin e parë të vitit 2025 po ashtu u zhvillua një diskutim i hapur mbi rastet e raportuara dhe u diskutua për dallimin dhe natyrat e ndryshme të rasteve.
- U diskutua edhe për rastin në një vajze minorene e cila është shqetësuar për qytetaret .
- Për këtë periudhë 6 mujore, numri i rasteve është me i madhe në krahasim me vitin e kaluar

- Ky takim shërbej edhe për njoftimin me disa mjete të cilat i posedon komuna e Istogut (GJPS).
- E domosdoshme ishte edhe themelimin i Tryezës për Menaxhimin e Rasteve (TMR) dhe doli si rekomandim themelimi i kësaj tryeze.
- Gatishmëria e zyrtarëve policor është në nivel në komunën e Istogut bashkë me institucionet e tjera janë në koordinim dhe efikasitet për mbrojtjen e viktimave dhe trajtimin e tyre.






## **Takimi i Tretë i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje**

- Me date 08.12.2025 u mbajt mbledhja e tretë për vitin 2025 Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje.
- Për këtë mbledhje ishin propozuar 4 pika të rendit të ditës .
- Pas miratimit të pikës së parë u diskutua për piken e dytë të rendit të ditës, të pranishmit u njoftuan për rastet e dhunës në familje në 6 mujorin e dytë të vitit 2025 po ashtu u zhvillua një diskutim i hapur mbi rastet e raportuara dhe u diskutua për dallimin dhe natyrat e ndryshme të rasteve.

- Me një shqetësim të madhe nga përfaqësues të institucioneve përkatëse të Mekanizmit Koordinues u tha se numri i rasteve të dhunës në familje është me i madhe në krahasim me periudhen e njëjtte të vitit të kaluar numri I rasteve recidiviste e rrit numrin e rasteve të dhunës në familje.
- Po ashtu u diskutua edhe për fuqizimin e personave të dhunës në familje nga ky takim dolën edhe disa rekomandime.



Kryetari i komunes

z. Ilir Ferati



Zyrtarja per Barazi Gjinore

Znj. Servete Haxhijaj



**AMBIENTI**  
KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

**Njësia Operative – Istog**

## **RAPORT VJETOR I PUNËS**

**K.R.M. "Ambienti" Sh.A.**

**Njësia Operative Istog**

Për periudhën: Janar – Dhjetor 2025

---

Për:

- Z. Ilir Ferati – Kryetar i Komunës së Istogut
  - Komisionin e Aksionarëve
  - Drejtorinë për Shërbime Publike
  - Asamblenë Komunale të Istogut
- 

Nga:

Ndërmarrja K.R.M. "Ambienti" Sh.A.

Njësia Operative Istog

---



## **Hyrje**

Ky raport vjetor paraqet aktivitetet, funksionimin dhe rezultatet e punës së K.R.M. “Ambienti” Sh.A. – Njësia Operative Istog për periudhën Janar–Dhjetor 2025, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ndërmarrja ushtron veprimtarinë e saj në bazë të:

- Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Statutit të Ndërmarrjes;
- Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Rregulloreve të brendshme të Ndërmarrjes “Ambienti”.

---

## **Veprimtaria e Ndërmarrjes**

Veprimtaria e K.R.M. “Ambienti” Sh.A. – Njësia Operative Istog ndahet në:

### **Veprimtaria primare**

Veprimtaria primare përfshin grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave shtëpiake në Deponinë Sanitare në Sferkë, Komuna e Pejës, si dhe bartjen dhe deponimin e mbeturinave nga institucionet e rëndësishme të veçantë, përfshirë Burgun dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) në Dubravë, Komuna e Istogut.

### **Veprimtaria sekondare**

Veprimtaria sekondare përfshin pastrimin dhe fshirjen e përditshme të sipërfaqeve publike, larjen e tyre, mirëmbajtjen e gjelbërimit, mirëmbajtjen e varrezave dhe memorialeve, si dhe angazhimin e fuqisë punëtore dhe mekanizmit gjatë aksioneve për rregullimin e ambientit dhe kryerjen e punëve të tjera në kuadër të veprimtarisë së Ndërmarrjes.

---

## **Shtrirja gjeografike e shërbimeve**

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike janë ofruar në 100% të territorit të Komunës së Istogut, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale.



---

### Struktura organizative

Gjatë vitit 2025, struktura organizative e Ndërmarrjes ka qenë e organizuar në këta sektorë:

- Sektori Administrativ;
- Sektori Operativ.

	Pozita	Numri
<b>Sektori administrativ</b>		
	Menaxher	1
	Zyrtar financiar	1
	Kontabilist	1
	Faturist	1
	Arkatar	1
	Inspektor	1
	Zyrtar për ankesa dhe kërkesa të klientëve	1
	Inkasantë	6
	Referët furnizimi	1
	Pastrues	1
<b>Sektori i operatives</b>		
	Kryepunëtor	2
	Automekanik	1
	Vozitës	8
	Punëtorë fizik	23
	Roje	2
<b>Totali</b>		<b>51</b>



Mosha mesatare e punëtorëve në Njësia Operative “Ambienti” Istog

Mosha	Nr.punëtorëve		Shkollimi	Nr.punëtorëve
63	1		Master	4
62	1		Fakultet	4
61	4		Sh.e lartë	1
60	1		Sh.mesme	33
58	1		Sh.Fillore	9
57	1			51
55	2			
54	2			
53	2			
52	2			
51	1			
49	4			
48	1			
47	1			
46	2			
45	1			
43	4			
41	1			
40	3			
39	2			
37	1			
36	3			
33	1			
32	2			
31	3			
29	1			
28	1			
27	1			
25	1			
<b>1302</b>	<b>51</b>	<b>25.52 mosha mesatare</b>		

Mosha mesatare e punonjësve të Ndërmarrjes është 25.52 vjet, që paraqet një strukturë të re dhe dinamike të stafit. Kjo moshë përbën një avantazh për veprimtarinë e Ndërmarrjes, duke reflektuar kapacitet të lartë pune, fleksibilitet operacional dhe potencial për zhvillim afatgjatë profesional.

Struktura e tillë e stafit ka ndikuar pozitivisht në realizimin e detyrave operative dhe në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të ofruara për qytetarët .



### FATURIMI DHE INKASIMI

Janar- Dhjetor 2025 janë lëshuar këto fatura mujore:

Nr	Muaj	Nr.fatura ve	Amvisëri	Institucion e	Biznes e	Shuma e faturimit me TVSH €	Shuma e inkasimit me TVSH €
1	Janar	10160	9261	66	833	69559.36	68306.97
2	Shkurt	10329	9422	66	831	70523.47	65936.60
3	Mars	10362	9457	66	839	70649.22	71101.58
4	Prill	10390	9479	66	845	71293.15	54821.64
5	Maj	10423	9505	66	852	81395.83	66163.73
6	Qershor	10475	9557	67	851	80065.93	76263.07
7	Korrik	10625	9709	67	849	81193.14	91783.88
8	Gusht	10700	9786	62	852	80561.23	100875.5
9	Shtator	10725	9806	66	853	79191.23	65408.59
10	Tetor	10728	9811	66	851	78780.93	66567.3
11	Nëntor	10743	9832	67	844	78388.24	80957.37
12	Dhjetor	10758	9844	69	845	87935.37	85875.78
	<b>Totali</b>	<b>126418</b>	<b>115469</b>	<b>794</b>	<b>10145</b>	<b>929536.90</b>	<b>894061.81</b>

Në periudhën Janar –Dhjetor janë regjistruar 598 klientë të rinj në të gjitha kategoritë e shërbimit.

Tabela e Faturimit dhe Inkasimit me TVSh për periudhën Janar –Dhjetor/2025

Nr.	Kategoria e Klientëve	Faturimi €	Inkasimi €	Përqindja (%)
1.	Amvisëria	602172.42	587941.78	97.64
2.	Institucionet	150774.37	131618.43	87.29
3.	Bizneset	176590.11	174501.60	96.35
	<b>TOTALI</b>	<b>929536.90</b>	<b>894061.81</b>	<b>96.18</b>



### Inkasimi i të hyrave

Gjatë vitit raportues, Ndërmarrja ka shënuar një nivel shumë të lartë të inkasimit të të hyrave. Përqindja e inkasimit ka arritur në 96.18%, që paraqet një rezultat shumë të mirë dhe të qëndrueshëm financiar.

Ky nivel i inkasimit dëshmon për:

- funksionim efikas të sistemit të faturimit dhe arkëtimit,
- bashkëpunim korrekt me konsumatorët,
- menaxhim të përgjegjshëm financiar,
- rritje të disiplinës së pagesave.

Arritja e këtij rezultati ka ndikuar drejtpërdrejt në stabilitetin financiar të ndërmarrjes dhe në mundësinë për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të vazhdueshme për qytetarët e Komunës së Istogut.

### Të hyrat dhe shpenzimet

Të hyrat e ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese janë realizuar nga inkasimet e kryera për shërbimet e ofruara ndaj klientëve.

Shpenzimet e realizuara gjatë vitit raportues, njësoj si në vitet paraprake, kanë qenë kryesisht të domosdoshme për mbarëvajtjen e aktivitetit operacional të ndërmarrjes dhe përfshijnë:

- Shpenzime për të ardhura personale të punëtorëve;
- Shpenzime për derivate të naftës, të cilat janë të pashmangshme dhe relativisht të larta, bazuar në natyrën dhe intensitetin e aktivitetit të ndërmarrjes;
- Shpenzime për ulje, goma, antifriz, bateri dhe materiale të tjera ndihmëse;
- Shpenzime për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, duke marrë parasysh se pjesa më e madhe e tyre është e vjetruar;
- Shpenzime për blerjen e rrobave të punës për punëtorët (xhaketa, pantallona, bluza/maica dhe këpucë pune);
- Shpenzime për pajisje mbrojtëse personale, si dorëza dhe çizme;
- Shpenzime për mjete pune, përfshirë: fshesa, lopata, kolica, kosa për bar, tela për trimer, bishta për lopata, grabuja dhe pajisje për gërryerjen e barit nëpër trotuare;
- Shpenzime për pjesë dhe materiale teknike, si: rotëza për kontejnerë, shpanera, llamarinë;
- Shpenzime për material administrativ, përfshirë: fatura, letër, tonera, blloqe për inkasantë, blloqe për shfrytëzim të automjeteve, lapsa, fletore, fascikla dhe foldera;
- Shpenzime kapitale për blerjen e dy kamionëve , një veture dhe një autofshise.



Specifikimi i shpenzimeve për vitin raportues/ 2025

Nr	Përshkrimi	Totali €
1	Shpenzimet e KES CO	1383.97
2	Shpenzimet e IPKO-S	360
3	Shpenzimet e Vala	655.84
4	Shpenzime Adminidtrative	2084.75
5	Shpenzimet e Naftës	94302.47
6	Shpenzimet e Vajrave	5878.50
7	Tatime dhe Kontribute ,QL tatimi në fitim	94271.34
8	TVSH	34803.15
9	Shpenzimet e provizionit	572.51
10	Shpenzimet e PAGAVE	396489.43
11	Shpenzimet e Auto gomave	12222
12	Shpenzimet e reprezentacionit	1374.2
13	Shpenzimet e Marketingut\shpallje	574
14	Shpenzimet e Regjistrimit te Automjeteve	9280.25
15	Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit , mjete punë	37908.83
16	Shpenzime higjienike	514.45
17	Mirembajtja e programit	10574.40
18	Blerja e inventarit për zyre	960
19	Blerja e dy kamionve	61952
20	Blerja e vetures	14250
21	Blerja e autofshises	39898
22	Pagesa për shërbimet e Menaxhmentit Pejë	30035.14
23	Të tjera	1457.03
24	Sigurimet shëndetsore	5805
25	Pagesa për Deponi	48000
26	Dorza,rroba pune	4627.50
27	Fatura dhe blloka të inkasantëve për Administrat	920.20
28	Tatimi në pronë	147.30
	<b>Totali</b>	<b>911302.26</b>

Të hyrat e realizuara gjatë periudhës raportuese arrijnë në 894,061.81 €, ndërsa shpenzimet në 911,302.26 €. Diferenca (17240.45€) e krijuar është rezultat i



drejtpërdrejtë i investimeve kapitale, rritjes së pagave si dhe mbulimit të shpenzimeve të domosdoshme për garantimin e funksionimit të rregullt dhe cilësor të shërbimeve publike.

Ky planifikim buxhetor reflekton një qasje realiste dhe përgjegjëse, të orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit operativ dhe zhvillimit afatgjatë të ndërmarrjes, pa cenuar ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Diferenca financiare konsiderohet e menaxhueshme dhe nuk paraqet rrezik për qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes.

### **Sektori i operatives**

Në këtë sektor janë të angazhuar shumica e fuqisë punëtore të Ndërmarrjes.

Në zonën e përfshirjes në rrjetin e mbledhjes së mbeturinave kemi të shpërndarë :

#### **Numri i kontejnerëve :**

<b>Nr.</b>	<b>vendbanimi</b>	<b>Nr. i kontejnerëve 1.1 m<sup>3</sup></b>	<b>Nr. i kontejnerëve të hapur (7m<sup>3</sup>,5m<sup>3</sup>)</b>	<b>Nr. i kontejnerëve 120L</b>	<b>Nr.i komposterve</b>
1	Banjicë				
2	Banjë	36			2
3	Belicë	1			
4	Bellopojë	3			
5	Carallukë				4
6	Cërkolez	1			
7	Cerrecë	6			3
8	Dobrushë	14			
9	Draglec	9			
10	Drejë				
11	Dubovë e Vogël				
12	Dubravë	1			
13	Gurakoc	34			2
14	Istog	161		600	10
15	Istog i poshtëm	6		180	3
16	Kaliqan	2			1
17	Kashicë	4			
18	Kërrninë	1			3
19	Kosh				
20	Kovragë	7			1



21	Llugë	2			1
22	Llukac i Begut	1			3
23	Llukac i Thatë				
24	Lubovë	4			7
25	Lubozhdë	7			
26	Mojstir				1
27	Muzhevinë	4			
28	Orrobërdë				
29	Osojan	3		100	
30	Polanë				
31	Prekallë				
32	Prigodë	1			1
33	Rakosh	9			3
34	Serbobran				
35	Shalinovicë				
36	Sinajë	7			5
37	Staradran	2			1
38	Studenicë				2
39	Suhogërlle	2			
40	Tomoc	3			6
41	Trubuhoc	1			
42	Tuçep				
43	Uçë	2			
44	Veriq	1			
45	Veriq i Ri				
46	Vrellë	17			12
47	Zablaq				
48	Zallq	11			
49	Zhakovë	1			
50	Kamenic	1			1
51	Shushicë	3			
52	Burgu	33			
53	F.S.K	22			
54	Devolli (Sinajë)	7	1		
55	Padalishtë				



56	Policia Jasenovik		1		
	<b>Totali</b>	<b>430</b>	<b>2</b>	<b>880</b>	<b>72</b>

Sasia e mbeturinave e deponuar në deponi Sferkë Pejë për Janar -Dhjetor 2025 është si vijon:

Nr	Muaj	Shprazjet në deponi Sferk	Sasia e mbeturinave T	Nafta L	KM
1	Janar	123	727.46	6470.90	23169
2	Shkurt	100	544.10	5769.55	22105
3	Mars	114	672.90	6343	22931
4	Prill	114	729.50	6519	23482
5	Maj	110	718.14	6908	25496
6	Qershor	110	702.10	7531	26550
7	Korrik	119	904.10	8583	29972
8	Gusht	160	1128	8826	30661
9	Shtator	127	859.6	7711	28124
10	Tetor	116	812.10	6839.64	27279
11	Nëntor	100	657.1	6756	25951
12	Dhjetor	120	814.5	7635	27259
	<b>Totali</b>	<b>1413</b>	<b>9269.6</b>	<b>85892.09</b>	<b>312979</b>

Mesatarja: Xhirot,mbeturinave në ton,Nafta dhe Km:

		Xhirot	Mbeturinave në ton	Nafta L	Km
<u>1</u>	Ditore	5.35	35.10	325.34	1185.52
<u>2</u>	Mujore	117.75	772.41	7157.64	26081.58
<u>3</u>	Vjetore	1413	9269.6	85892.09	312979

Numri i ditëve të punës të realizuar në mbledhje dhe bartjen e mbeturinave: 338 ditë.  
Numri i ditëve të punës të realizuar në mirëmbajtjen e hapsirave publike: 363 ditë.



**Automjetet**

<b>Automjetet për grumbullim dhe transport të mbeturinave</b>				
Nr	Tipi	Kapacite ti ton	Viti i prodhimit	Targat
1	Ford	7 T	2011	03-671-EI
2	Mercedes Automatik	11 T	2000	03-571-ET
3	Ivecok Calabrez	5T	2000	03-207-GO
4	Merceds me Grepa	5T	1987	03-149-IQ
5	Fap14x14	7T	1989	03-677-AH
6	Kamionet T4	1T	2000	03-453-AI
7	Mercedes 3.4t	3.4T	2004	03-206-GO
8	Man	5T	2007	03-219-HD
9	Mercedes Benz	5T	2022	03-690-HP
10	Traktor	-	-	Në shfrytzim
11	Iveco Automatik	7 T	2009	03-856-ID
12	Mercedes Bens Actros 03-413-JH	9T	2008	03-371-JH
13	Mercedes Bens Actros 03-371-JH	9T	2008	03-413-JH
14	Veturë Golf		2018	03-740-JI
15	Autofshis		2017	03-452-JL



**Plani Operative Janar-Dhjetor 2025**

Plani Operative		K.R.M "Ambenti"	Njësia Operative Istog	
<b>DITET E JAVËS</b>			Vendbanimet që shërbehen, sipas rradhitjes në teren	Vendi ku zbrazen mbeturinat
<b>E Hënë</b>	1		Gurrakoc	Deponia-Sferkë
	2		ISTOGU Zona qendër- RR. Lidhja e Prizerenit -RR. Deshmort Dervishaj BURGU-	Deponia- Sferkë
	3		Tomoc 2 lagje, Serbobran, Osmanaj ,Gurrakoc, Prekallë. Dobrushë 2 lagje, Kamenicë,Vrellë Qendra,Lagj Dreshaj në Vrellë, lagj Idrizaj Lubozhdë, Lagj Hajdint bekt në Cerrcë, Istog Lagj Bytyqt, Lagj Llullakve- RR.Hasan Prishtina-Rrugës Hasan Halili	Deponia- Sferkë
	4		Llugë,Kerrninë e Epermë, Zhakovë. Cerkolezë, Suhogerllë	Deponia-Sferkë
	5		Banjë, Lubovë	Deponia- Sferkë
<b>E Martë</b>	1		FSK- Kovragë	Deponia- Sferkë
	2		Istog Zona qendër- RR. UÇK -RR. Hysen Bujupi -RR. Femi Agani	Deponia- Sferkë
	3		-Cerrcë- Lubozhdë	Deponia-Sferkë
	4		Kashicë, Staradran	Deponia-Sferkë
	5		Veriq, Dubravë- Llukafc i Begut- Dobrushë	Deponia- Sferkë



<b>E Merkurë</b>	1		Tomoc, Muzhevinë, Lagj Arifaj	Deponia-Sferkë
	2		Istog Zona qendër- Burgu- Laqeja Shqiponja -RR. Drita e Parë, -RR. Arben Januzaj,-RR.Bajram Gashi-RR. Nimon Shabani	Deponia-Sferkë
	3		Orroberdë, Kaliqani, Qendra Vrellë	Deponia-Sferkë
	4		Trubohocë, Zbllaq. Osojan, Kerrninë e Ultë	Deponia- Sferkë
	5		Bollopojë- Gurrakoci- Banjë	Deponia- Sferkë

<b>E Enjte</b>	1		Istog Zona Qendër- Synë- Mojstirë- Shushicë	Deponia- Sferkë
<b>E Premte</b>	1		Cerrollukë, Banjë, Baic, Dubovë e vogel, Istog i Poshtëm	Deponia- Sferkë
	2		Istog Zona qendër- BURGU, RR. UÇK, -RR. Hysen Bujupi, -RR. Lidhja e Prezrenit -RR. Dëshmorët Dervishaj	Deponia-Sferkë
	3		Studenicë, Stupe, Kamenicë	Deponia- Sferkë
	4		Uqë, Rakosh, Kerrninë e Eperme	Deponia-Sferkë
	5		Istog- Gurrakoc- Zallq- Drejë-Kosh- RR- Pjetër Lorenc Mazrreku, Shalinovicë	Deponia-Sferkë
<b>E Shtune</b>	1		Drogolecë -Prigodë	Deponia-Sferkë
	2		Istog Zona qendër- Lagjja Blakaj, -RR. Rexhë Murati, -RR. Shaban Moni,- RR, Liria,- RR.Dheu i Bardh -RR. Selim Bajrami,-RR. Tirana -RR. Gazmend Zajmi -RR. Hajzer Hajzeri- RR. Rexhë Destani, -RR. 12 Prilli -RR. Drita e Parë	Deponia- Sferkë



	3		Vrellë me të gjitha rrugët	Deponia-Sferkë
	4		Banjë, Gurrakoc zona qendër	Deponia- Sferkë
<b>E Diel</b>				
	1		Istog, Banjë, Gurrakoc zonat qendër	Deponia- Sferkë

### **Raporti i punës për Janar-Dhjetor 2025**

- Janë shqyrtuar kërkesa të qytetarëve që lidhen me shërbimet e ofruara nga kjo Ndërmarrje si dhe ngarkesat e tyre me obligime;
- Zgjerimi i veprimtarisë së grumbullimit të mbeturinave derë me derë.
- Vendime të tjera.
- Gjatë muajve Janar- Dhjetor 2025 është punuar sipas planit operativ për menaxhim të mbeturinave.

Në vazhdimësi kemi realizuar fshirjen e rrugëve dhe trotuareve në të gjithë qytetin, gjithashtu edhe nëpër zonat urbane si: Banjë, Vrellë, Gurrakoc, Zallq, Rakosh.

Mirëmbajtjen e hapësirave publike si: parqe ,varrezave, memorialve të dëshmorve, larje të rrugëve.



**1.Pastrimi i rrugëve publike  
në komunën e Istogut**

Muaj	Sipërfaqja e perfunduar m <sup>2</sup>
Maj	808550
Qershor	476500
Korrik	404875
Gusht	541045
Shtator	590305
Tetor	624385
Nëntor	668885
Dhjetot	1919170
<b>Totali</b>	<b>5225165</b>

**2.Larja e rrugëve publike në komunën  
e Istogut**

Muaj	Sipërfaqja e perfunduar m <sup>2</sup>
Maj	88950
Qershor	46470
Korrik	46470
Gusht	54420
Shtator	54420
Tetor	35930
Nëntor	39380
Dhjetot	0
<b>Totali</b>	<b>277090</b>

**3.Pastrimi i memorialve të Dëshmorëve  
në Komunën e Istogut**

Muaj	Sipërfaqja e perfunduar m <sup>2</sup>
Maj	9318
Qershor	9318
Korrik	9318
Gusht	9318
Shtator	9318
Tetor	9318
Nëntor	9318
Dhjetot	9318
<b>Totali</b>	<b>65226</b>

**4.Pastrimi i Varrezave  
në Komunën e Istogut**

Muaj	Sipërfaqja e perfunduar m <sup>2</sup>
Maj	101385
Qershor	111665
Korrik	120588
Gusht	70230
Shtator	58211
Tetor	58822
Nëntor	60810
Dhjetot	189548
<b>Totali</b>	<b>771259</b>



**5.Mirëmbajtja dhe Pastrimi i parqeve publike në Komunën e Istogut**


3.2.5. Mbështetje e organizatave-shoqëritë kulturore artistike të vajzave dhe të të reja ve. Janë mbështetur edhe nxënës për promovimin e librit. Aktivitetet që janë mbajtur janë: Java e Bashkëatdhetarëve, 28 Nëntori. Vlera totale e mbështetjes për këto aktivitete është 1,500 Euro.	DKRS	OJQ ON	2024 - 2026	3,000 € (komuna)	3,000 € (komuna)	3,000 € (komuna)	DKRS Donatorët	- 12 aktivitete me organizatën shoqërore kulturore – artistike (4 aktivitete në vit).	ZK GM
3.2.7. Publikimi i një broshure me të dhëna dhe histori të grave me kontribute në Istog.  Ky aktivitet është shtyrë që të mbahet në vitin 2026.	DKRS	ZK ZBGJMD OJQ ON	2025	/	2,700 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,400 € hendek financiar)	/	DKRS Donatorët	- 1000 broshura të përgatitura dhe publikuar në vitin 2025	ZK GM
3.2.8. Takime informuese me të reja dhe të rinj, mbi rolin e grave ndër vite në Komunën e Istogut (bazuar te broshura e përgatitur).  Ky aktivitet është shtyrë që të mbahet në vitin 2026.	DKRS	ZBGJMD DKA OJQ ON	2025	/	3,614 € (nga të cilat 3,250 € komuna dhe 364 € hendek financiar)	/	DKRS Donatorët	- 13 takime të zhvilluara në vitin 2025  - 325 persona/nxënës të informuar në vitin 2025 të ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	ZK GM





AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mpëshkëtëse		2024	2025	2026			
4.1.2. Takime informuese në kuadër të fushatës "Tetori rozë".	DSH	SDNJK	2024 - 2026	2,177 € (nga të cilat 941 € komuna dhe 1,236 € hendek financiar)	2,177 € (nga të cilat 941 € komuna dhe 1,236 € hendek financiar)	2,177 € (nga të cilat 941 € komuna dhe 1,236 € hendek financiar)	DSH Donatorët	- 9 takime të zhvilluara (3 në vit)	ZK GM
Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi, OJQ "Vizion 02" dhe OSBE gjatë muajit Tetor "Muaj Rozë", bazuar edhe në Planin e Punës së Sektorit dhe Planin e Veprimit Lokal për Barazi Gjinore 2024-2026 organizuam fushatën e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës mitrës. Takime informuese u mbajtën me gratë në Zallq dhe Istog. Për këtë temë me takime ligjërroi Dr.Egzona Hajrizaj Hoxhaj. Në këto takime morën pjesë 102 pjesëmarrës/e, 95 F dhe 7 M që përftuan									

njohuri për zbulimin e hershem të kancerit të gjirit dhe kancerit të gafës mitrës.									
4.1.5. Sesionet informuese për kancerin e gafës së mitrës, sidomos me gratë dhe të rejtat në zonat rurale. Sesione informuese për kancerin e gafës së mitrës, në zonat Zallq dhe Istog. Për këtë temë me takime ligjërroi Dr.Egzona Hajrizaj Hoxhaj. Në këto takime morën pjesë 102 pjesëmarrës/e, 95 F dhe 7 M	DSH	QKMF	2024 - 2026	948 € (nga të cilat 612 € komuna dhe 336 € hendek financiar)	948 € (nga të cilat 612 € komuna dhe 336 € hendek financiar)	948 € (nga të cilat 612 € komuna dhe 336 € hendek financiar)	DSH	- 9 sesione të zhvilluara (3 në vit) - 225 persona të informuar (75 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	ZK GM

Ky raport është hartuar në tri(3) kopje Identike, me nga një kopje te njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste dhe;
3. Komiteti për Barazi Gjinore.

Grupi Monitorues:

Afrim Metaj, kryesues i grupit;   
 Servete Haxhiqaj, anëtare;   
 Albert Hasanaj, anëtar.  
 Arta Fetahu, anëtare;   
 Alketa Bujupaj, anëtare; 





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosova



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

01 Nr.Br 1405/2025

Data: 30.12.2025

## **Raporti Vjetor 2025 i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës Istog (2024 - 2026)**

### **1. Anëtarët përgjegjës për realizimin e aktiviteteve sipas Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026)**

- 1.1. Ilir Ferati - Kryetari i Komunës, Kryesues i Ekipit;
- 1.2. Merita Bytyçi - Drejtorja për Mirëqenie Sociale, zëvendës kryesuese e Ekipit;
- 1.3. Naim Behlulaj - Drejtorja për Arsim, anëtar;
- 1.4. Zenel Shatri - Drejtorja për Shëndetësi, anëtar;
- 1.5. Vlora Vuthaj - Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare;
- 1.6. Genc Ademaj - Drejtorja për Buxhet dhe Financa, anëtar;
- 1.7. Liridona Lajçi - Anëtar i deleguar nga Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës, anëtare;
- 1.8. Afrim Istrefaj - Anëtar i deleguar nga Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës, anëtar;
- 1.9. Vlora Gjoci - Zyrtare për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, anëtare/sekretare e Ekipit;
- 1.10. Fadil Hoxhaj - Policia, anëtar;
- 1.11. Haki Ibrahimaj - Qendra për Punë Sociale, anëtar;
- 1.12. OJQ "Vision 02" - Përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar;

### **2. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe këshilltarëve të jashtëm janë:**

- 2.1 Erin Gërguri - Përfaqësuesi i fëmijëve apo grupit të fëmijëve;
- 2.2. Enver Balaj - Kryetari i Këshillit të Prindërve;
- 2.3. Përfaqësuesi nga zyra rajonale e Institucionit të Avokatit të Popullit;
- 2.4. Përfaqësuesi i organizatave vendore dhe ndërkombëtare;

Në vitin 2025 nga Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në Istog janë mbajtur 4 takime të rregullta, ashtu siç janë të parapara me Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, si dhe në kuadër të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024 - 2026) nga anëtarët përkatës të Ekipit janë realizuar aktivitete të cilat janë të përfshira në gjashtë fushat e Planit të Punës për vitin 2025:

- **Shërbime cilësore e gjithëpërfshirëse për fëmijë**
- **Vetëdijësimi dhe avokimi për fëmijë**
- **Hapësira të sigurt dhe miqësore për fëmijë**
- **Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijë**
- **Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje**
- **Koordinim, vlerësimi dhe raportimi.**

#### **Takimet e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës gjatë vitit 2025:**

**Takimi i parë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës** është mbajtur më qëllim të diskutimit lidhur me rezultatet e arritura dhe sfidat e Raportit Vjetor 2024 të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës Istog (2024 - 2026), si dhe organizimi i aktiviteteve të Planit të Punës së Ekipit (2024-2026) për tremujorin e parë të vitit 2025.

**Takimi i dytë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës** është mbajtur me rastin e shënimit të 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, i cili ishte takimi i përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog dhe anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Qëllimi i këtij takimi të përbashkët ishte krijimi i mundësisë së përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve të ngritin çështje të rëndësishme që prekin të drejtat dhe mirëqenien e të gjithë fëmijëve, duke përfaqësuar në këtë mënyrë me dinjitet shkollat komunitetin që përfaqësojnë.

**Takimi i tretë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës** është mbajtur me qëllim të diskutimit dhe koordinimit të aktiviteteve të cilat janë të planifikuara në Planin e Punës. Gjatë takimit u miratua procesverbali i takimit të dytë të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa diskutimet u fokusuan në Raportin Gjashtëmujor Janar – Qershor 2025, i cili reflekton përkushtimin e institucioneve në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe në përmbushjen e objektivave të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës Istog (2024 - 2026).

#### **Rekomandime të dala nga ky takim:**

- Të mbahen punëtori më anëtarët e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës më fokus tek tema për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve si dhe siguria dhe mirëqenia e fëmijëve në shkolla dhe komunitet;
- Takime vetëdijësuese me mësuesin, prindër dhe nxënës për parandalimin e dhunës;

**Takimi i katërt dhe përmbyllës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës** është mbajtur më anëtarët e këtij Ekipi dhe si qëllim kishte miratimin e procesverbalit nga takimi i tretë i Ekipit si dhe diskutimin më në detaje mbi implementimin e aktiviteteve, me fokus të veçantë aktivitetet që janë realizuar përgjatë vitit 2025.

Ky takim shërbeu gjithashtu si reflektim mbi punën e deritanishme dhe si një bazë e fortë për planifikimet dhe angazhimet e ardhshme mbi implementimin e aktiviteteve të Planit të Punës për Ekipi Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).

**Rekomandime të dala nga takimi i katërt dhe përmbyllës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës:**

- Organizimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese në bashkëpunim me institucionet përkatëse në fushën e mbrojtjes së fëmijëve për rastet e fëmijëve në situatë rrugë;
- Bashkëpunim me funksional ndërmjet Këshillit të Prindërve dhe shkollave lidhur me çështjet e sigurisë në shkolla sa i përketë përdorimit të narkotikëve, armeve të ftohta dhe mjeteve të tjera që janë të rrezikshme dhe nuk janë të lejuara;
- Krijimi i një databazë nga Drejtoria Komunale e Arsimit për identifikimin dhe regjistrimin e talenteve të rinjë në fusha të ndryshme;

**Aktivitetet e realizuara përgjatë vitit 2025 nga Anëtarët e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës sipas Planit të Punës për Ekipi Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026)**

**1. Aktivitetet e realizuara nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale – Qendra për Punë Sociale**

**Objektiva Strategjike 1:** Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë

**Objektiva specifike 1.1:** Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë

**Rezultatet 1.1:** Në kuadër të shërbimeve sociale nga Qendra për Punë Sociale përgjatë vitit 2025 janë ofruar shërbime të ndryshme për kategoritë si në vijim:

	Kategoritë	Nr i rasteve	Përshkrimi Shërbimeve të ofruara në Sektorin e Shërbimeve Sociale
1.	Fëmijë të braktisur	2	Përcaktimi i kujdestarit ligjor, vendosja në strehim familjar, ndihmat e përgjithshme për familjet strehuese dhe për fëmijë, puna me familjen biologjike , regjistrimi i fëmiut në LAL, puna me familjen potenciale adoptuese etj.
2.	Adoptim	0	Adoptimi është një aspekt i mbrojtjes së fëmijës, vlerësimi i familjes për adoptim dhe monitorimi i fazës paraadoptuese
3.	Keqtrajtim i fëmijës	8	Këshillim psiko-social me familje

4.	Strehim familjar në familje strehuese	12 (2 fëmijë të rikthyer në familjen biologjike)	Ofrimi i strehimit fëmijëve të braktisur dhe të lënë pas dore dhe përcjellja e trajtimit të fëmijëve në familje strehuese
5.	Strehim familjar tek të afërmit	0	Ofrimi i strehimit tek familja e gjerë dhe përcjellja e zhvillimit dhe trajtimit të tyre
6.	Kujdestaria për të mitur	2	Fëmijëve pa kujdes prindëror u caktohet kujdestari ligjor
7.	Fëmijë me aftësi të kufizuar të plotë	20	Kompletimi i dokumentacionit, pas vlerësimit të komisionit mjekësor pozitivisht për kërkesën ofrohet pagesa përkatëse si dhe monitorimi i Qendrës Ditore për FAKP dhe udhëzimet e nevojshme
8.	Braktisje e shkollës	8	Bashkëpunimi shkollë – prind – fëmijë si dhe këshillime për të gjitha këto në interes më të mirë të fëmijëve
9.	Fëmijë me vështirësi në sjellje	39	Këshillime psiko-sociale për të mitur
10.	Të mitur në konflikt me ligjin	64	Këshillim dhe ofrim i shërbimit përkatës për referim në institucionet relevante
11.	Martesa e të miturve	0	Vlerësimi i pjekurisë emocionale të të miturve të cilët dëshirojnë të hyjnë në martesë si dhe referimi në institucionet tjera.
12.	Ikje nga shtëpia	0	Këshillim psiko-social, rikthim në familje dhe përcjellja e zhvillimit të përgjithshëm të të miturit
13.	Besim i fëmijës	9	Besimi i fëmijës kërkohet nga Gjykata që Organi i Kujdestarisë të jap mendimin se cili është interesi më i mirë i fëmijës kujt t'i besohet , realizohen vizita në familje rreth identifikimit të kushteve ekonomike dhe sociale të të dy prindërve.
14.	Kontaktime	9	Me vendim të Gjykatës ku specifikohet që kontaktimi të mbahet në QPS ne i përcjellim rastet që këto kontaktime të realizohen në mënyrë të duhur.

**Objektiva specifike 1.2:** Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme

**Rezultatet 1.2:** Kontraktimi i operatorëve lokal për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët si: (mallra, ushqim, transport, etj.) për furnizim me ushqim dhe veshmbathje për fëmijët në nevojë, në situata rruge duke u bazuar nga raportet e organit të kujdestarisë

**Objektiva specifike 1.3:** Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore

**Rezultatet 1.3:** Komuna e Istogut i ka përmbushur standardet minimale të strehimit familjar dhe ka arritur të ketë gjithsej 3 familje strehuese, të cilat i kanë gjithsej 12 fëmijë në strehim familjar, 5 nga të cilët janë nga komuna jonë kurse 7 nga komuna të tjera.

Nga Komuna e Istogut dhe organizatat e ndryshme, familjet strehuese dhe fëmijët në strehim po ashtu kanë përkrahje të vazhdueshme në forma të ndryshme financiare dhe materiale (pako ushqimore dhe higjienike).

**Objektiva specifike 1.11:** Identifikimi i hershme i fëmijëve me nevoja të veçanta

**Rezultatet 1.11:** Qendra për Punë Sociale në kuadër të angazhimit për përmirësimin e qasjes në shërbime, ka organizuar një sërë sesionesh informuese me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të veçanta ku janë diskutuar nga afër sfidat dhe nevojat konkrete të familjeve duke u mundësuar prindërve që të ndajnë përvojat dhe shqetësimet e tyre dhe janë njoftuar për shërbimet që do të ju ofrohen nga komuna.

**Rezultatet 1.11:** Nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale janë organizuar aktivitete të ndryshme për fëmijët me nevoja të veçanta.

- Aktivitet më rastin e shënimit të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve ku janë organizuar lojëra dhe aktivitete të ndryshme argëtuese për t'i festuar dhe për t'u dhënë një ditë të veçantë plot gëzim dhe kujtime të bukura.
- Aktivitete mes nxënësve dhe të moshuarve për ruajtjen e vlerave tradicionale, ku në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet SHFMU “Martin Camaj” dhe Shtëpisë së Pleqve në Gurrakoc, janë realizuar një sërë aktivitete me karakter edukativ dhe social, me qëllim forcimin e lidhjeve ndërmjet brezave dhe promovimin e vlerave tradicionale.
- Një ndër aktivitetet më domethënëse ka qenë “Gara e Gatimit”, ku fëmijët dhe të moshuarit kanë ndarë përvoja dhe receta tradicionale, duke përgatitur ushqime së bashku në një atmosferë të ngrohtë dhe bashkëpunuese.
- Aktivitet tjetër nga nxënësit e SHFMU “Martin Camaj” ishte realizimi i projektit “Kopshtaria Humanitare” – një iniciativë për ndërtimin e një kopshti të përbashkët në ambientet e Shtëpisë së Pleqve. Gjatë këtij aktiviteti, u mbollën lule të ndryshme me pjesëmarrjen aktive të të moshuarve dhe fëmijëve, duke nxitur ndjeshmërinë sociale dhe kujdesin për mjedisin. Këto iniciativa dëshmojnë rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve ndërmjet brezave dhe promovimit të solidaritetit në komunitet.
- Shënimi i 3 Dhjetorit – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara ku po në këtë ditë përveç shënimit të aktivitetit është realizuar edhe shpërndarja e dhuratave për fëmijë me aftësi të kufizuara.

**Objektiva specifike 1.12:** Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

**Rezultatet 1.12:**

- Janë subvencionuar organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në bashkësi, për fëmijët me aftësi të kufizuara si OJQ “Handikos” në Istog dhe “Qendra për Jetë të Pavarur” me seli në Pejë, për ofrimin e shërbimeve ditore për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale, në kuadër të projektit SOR13 të mbështetur nga organizatat NALAS dhe GIZ, ka bërë të mundur ofrimin e një game të gjerë shërbimesh për fëmijët me nevoja të veçanta në komunën e Istogut dhe si rezultat këta fëmijë përfitojnë nga trajtime logopedike, mbështetje psikologjike dhe asistencë sociale të ofruara nga profesionistë të kualifikuar, duke ndihmuar në zhvillimin e tyre personal dhe përfshirjen e tyre më të plotë në shoqëri.
- Qendra për Punë Sociale në kuadër të angazhimit për përmirësimin e qasjes në shërbime, ka organizuar një sërë sesionesh informuese me prindërit e fëmijëve me nevoja ku janë diskutuar nga afër sfidat dhe nevojat konkrete të familjeve duke u mundësuar prindërve që të ndajnë përvojat dhe shqetësimet e tyre dhe janë njoftuar për shërbimet që do të ju ofrohen nga komuna.

## 2. Aktivitetet e realizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

**Objektiva strategjike 3:** Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët

**Objektiva specifike 3.1:** Sigurimi i sistemit të trafikut të është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

**Rezultatet 3.1:** Në kuadër të këtij objektivi, është trajtuar si çështje prioritare dhe mjaft specifike siguria e fëmijëve në ambientet shkollore në territorin e komunës.

Në këtë drejtim, gjatë vitit raportues janë realizuar ndërhyrjet vijuese në Sh.F.M.U. “Hysni Zajmi” në Vrellë:

- Është rregulluar oborri i sallës së sporteve, duke mundësuar qasje të kontrolluar për automjetet, pa e penguar procesin mësimor dhe pa cenuar sigurinë e nxënësve.
- Përreth kësaj hapësire është realizuar mbjellja e barit, me qëllim të rritjes së gjelbërimit dhe krijimit të një ambienti më të shëndetshëm, të sigurt dhe më miqësor për fëmijët.

Këto ndërhyrje kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies së nxënësve, si dhe në krijimin e hapësirave shkollore funksionale dhe të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve arsimore dhe sportive.

**Objektiva Strategjike 4:** Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit

**Objektiva specifike 4.1:** Promovimi i sportit nëpër shkolla

**Objektiva specifike 4.2:** Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja

**Rezultatet në Sport 4.1 dhe 4.2:** DKRS ka kontaktuar me mësimmshënësit e edukatës fizike dhe, bazuar në informatën e pranuar, është konstatuar se në të gjitha shkollat e Komunës së Istogut funksionojnë klube sportive aktive në kuadër të programit “Sporti Shkollor”, të cilat zhvillojnë aktivitete sportive në disiplina të ndryshme.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor - DKRS ka organizuar dhe përkrahur një sërë aktiviteteve sportive dhe kulturore, si për fëmijët anëtarë të klubeve sportive, ashtu edhe për nxënësit e shkollave të Komunës së Istogut.

### **SPORT**

- Organizimi i aktiviteteve tradicionale sportive, siç është Turniri Tradicional në Hendboll nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulëtë “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” në Uçë.
- Kategorizimi i klubeve sportive, nga i cili përfitojnë të gjitha klubet sportive, duke marrë parasysh se shumica e anëtarëve të klubeve sportive në Komunën e Istogut janë fëmijë.
- Rregullimi dhe përmirësimi i hapësirave dhe objekteve sportive, ku përfshihen:
- Përfundimi i ndërtimit të Fushës Ndihmëse të Futbollit me bar sintetik;
- Palestra e Sporteve është ende në proces të punimeve, ndërsa të gjitha klubet sportive janë sistemuar në hapësira alternative deri në përfundimin e punimeve;

- Mirëmbajtja e fushës sportive;
- Përfundimi me sukses i ndërtimit të Sallës Sportive të SHFMU “Hysni Zajmi” në Vrellë, me vlerë investimi prej 200,000 euro gjatë vitit 2025, ku tashmë kanë filluar aktivitetet fizike dhe rekreative për nxënësit.

**Objektiva Strategjike 4:** Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit

**Objektiva specifike 4.3:** Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë

**Objektiva specifike 4.4:** Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

**Objektiva specifike 4.5:** Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin

**Rezultatet në Kulturë 4.3 4.4 dhe 4.5:** Gjatë periudhës raportuese, DKRS ka organizuar dhe përkrahur një sërë aktiviteteve kulturore dhe artistike me qëllim promovimin e vlerave kulturore, edukative dhe krijuese të fëmijët dhe të rinjtë e Komunës së Istogut.

## KULTURË

- Koncert festiv për fëmijë “Kosova 17”, i organizuar me rastin e shënimit të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Program kulturor-artistik me këngë dhe valle popullore, i mbajtur me rastin e 12 Prillit – Dita e Dëshmorëve të Istogut, i realizuar nga fëmijët e Shtëpisë së Kulturës “Adem Jashari”.
- Promovimi i përmbledhjes poetike “Zjarri i Fjalës”, që përmban krijime letrare të nxënësve të shkollave të Komunës së Istogut.
- Promovimi i librit “Dritë në Errësi”, me autore nxënëse të SHML “Haxhi Zeka”, duke inkurajuar krijimtarinë letrare të rinjtë.
- Me rastin e Ditëve të Bashkatdhetarëve, janë organizuar aktivitete kulturore dhe rekreative për tre net radhazi, përfshirë:
  - Koncerte për fëmijë;
  - Aktivitete sportive të organizuara nga Klubi i Futbollit të Femrave “KFF Istogu”, të mbajtura për dy net radhazi në Parkun e Qytetit;
  - Aktiviteti kreativ “Pikturojmë së bashku”, i realizuar me fëmijët që frekuentojnë Parkun e Qytetit.
- Koncert për fëmijë, i organizuar për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar.

### 3. Aktivitetet e realizuara nga Drejtoria e Shëndetësisë

**Objektiva Strategjike 1:** Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë

**Objektiva specifike 1.9:** Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit

#### **Rezultatet: 1.9:**

- Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.
- Gjatë vitit 2025, për programet e kujdesit për nëna dhe fëmijë, të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe organizatat e tjera, janë trajnuar 10 infermiere dhe mami si dhe 5 mjekë.

**Objektiva specifike 1.10:** Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike

#### **Rezultatet 1.10:**

- Në kuadër të zbatimit të politikave shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë, QKMF-ja ofron shërbime të organizuara dhe sistematike për kujdesin ndaj nënës dhe fëmijës. Ky program ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve përmes vizitave të rregullta, edukimit shëndetësor dhe ndjekjes së vazhdueshme gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes.  
Programi i vizitave shtëpiake është të sigurojë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata që për arsye shëndetësore, sociale apo ekonomike nuk kanë mundësi të vizitojnë qendrën shëndetësore.  
Përmes programit të Ministrisë së Shëndetësisë janë trajnuar stafi infermior i QKMF, QMF dhe i AMF, për vizitat e kujdesit shëndetësorë për nëna dhe fëmijë.
- Nga ekipi për kujdesin shtëpiak gjatë vitit 2025 për nëna dhe fëmijë janë realizuar gjithsej **719 vizita**, vizita të cilat janë realizuar duke i zbatuar programet e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Zbatimi i praktikave efektive të kujdesit perinatal ku përmes trajnimeve dhe implementimit të protokolleve të reja të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë, stafi i QKMF-së ofrojnë praktikave më efektive për kujdes perinatal.
- Gjatë vitit 2025 janë të angazhuara dy ekipe vetëm për ofrimin e vizitave shtëpiake, që përfshijnë të gjitha ndërhyrjet infermiere, dhe vizita e mjekut kur është e nevojshme.
- Në vitin 2025, në gjitha institucionet shkollore: para fillorë, fillore dhe të mesme në gjithë komunën e Istogut është realizuar programi i vizitave sistematike, në të cilin program janë përfshirë mjekë familjarë, stomatolog dhe infermierë. Ky program përfshin shërbime të organizuara për kontrollin, parandalimin dhe promovimin e shëndetit të nxënësve.

#### **4. Aktivitetet e realizuara nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim - Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale**

**Objektiva Strategjike 1:** Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë

**Objektiva specifike 1.3:** Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore

**Rezultatet 1.3:**

##### **15 Maji “Dita Ndërkombëtare e Familjes”**

Me rastin e shënimit të 15 Majit “Dita Ndërkombëtare e Familjes” nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale është organizuar një tryezë me familjet strehuese në Istog, më qëllim të diskutimit për përvojat e tyre, nevojat dhe sfidat që i hasin si familje strehuese gjatë strehimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të braktisur nga lindja, keqtrajtuar e të neglizhuar nga familja e tyre biologjike.

Tryeza e mbajtur ishte një mundësi që familjet strehuese të diskutojnë hapur mbi vështirësitë që hasin gjatë strehimit të fëmijëve dhe një mundësi për të dëgjuar njëri - tjetrin, për të mësuar për përvojat e ndryshme dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta që e lehtësojnë këtë rrugëtim.

**Objektiva Strategjike 2:** Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

**Objektiva specifike 2.2** Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët

**Rezultatet 2.2:**

##### **Fushata vetëdijesuese me nxënës/e për promovimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe Planin e Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026)**

Nga anëtarët e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në bashkëpunim me organizatën “Syri i Vizionit” janë mbajtur sesione informuese me nxënës për promovimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe prezantimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026) në të gjitha shkollat e komunës së Istog.

Në këto sesione kanë marrë pjesë drejtorë, drejtoresha të shkollave, koordinator/e, mësimdhënës/e si dhe përfaqësues të nxënësve/fëmijëve të të gjitha komuniteteve nga klasa VI, VII, VIII, IX, X dhe XI.

- Si rezultat nga sesionet e mbajtura me nxënës për promovimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026) janë informuar gjithsej 404 nxënës/e prej tyre 182 M dhe 222 F.

### Rekomandime të dala nga sesionet e mbajtura me nxënës/e:

- Mbajtja e fushatave parandaluese kundër dhunës dhe bullizmit në shkolla;
- Informimi i nxënësve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Pajisja e shkollave më mjetet e duhura që lëndët mësimore të realizohen me instrumente konkrete sidomos Kabineti i Biologjisë, Fizikës, Tikut, Muzikës;
- Të këtë pjesëmarrje më të madhe të fëmijëve në vendimmarrje dhe të dëgjohet zëri i tyre;
- Të ketë hapësira më të mëdha në shkolla për lojë, sport dhe rekreacion;
- Pajisja e bibliotekës më orendi dhe hapësira më të mëdha për lexim;
- Hapja e bufeve në shkolla;
- Furnizimi i shkollave më mobile të reja në shkolla (banka, karrige);
- Higjiena në ambientet e shkollës;

### Numri i nxënësve/fëmijëve të informuar sipas shkollave dhe gjinisë

Shkollat	Numri nxënësve	Meshkuj	Femra
Hysni Zajmi - Vrellë	43	21	22
Zymer Zeka - Kaliqan	36	18	18
Trepça – Banjë, Mehmet Akif - Shushicë	32/8 17	7/6 7	25/2 10
Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe - Uçë	24	12	12
Ndre Mjeda - Rakosh	34	17	17
Martin Camaj - Gurrakoc	13	9	4
IAAP Mithat Frashëri - Gurrakoc	31	19	12
Fan S.Noli - Llukafc i Begut dhe Dobrushë	32/40	14/22	18/18
Ismail Qemali - Saradran	30	9	21
Avni Rustemi - Zallq	15	4	11
Bajram Curri - Istog	24	9	15
Gjimnazi Haxhi Zeka - Istog	22	8	14
<b>Total</b>	<b>404</b>	<b>182</b>	<b>222</b>

## **21 Marsi “Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down”**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale, në bashkëpunim me OJQ “Handikos” në Istog dhe iniciuesën e këtij aktiviteti, Fatbardha Hakaj Demaj, kryetare e Këshillit të Prindërve të Kopshtit “Gëzimi Ynë”, ka organizuar një aktivitet të veçantë në “Parkun e Qytetit” në Istog.

Ky aktivitet ka mbledhur së bashku prindër dhe fëmijë/persona me Sindromën Down, me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe mbështetjes për këtë komunitet dhe u promovua mesazhi për një shoqëri më të barabartë dhe më të ndjeshme ndaj diversitetit.

Aktiviteti është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndërtuar një shoqëri që i pranon dhe i mbështet të gjithë pa dallim.

## **12 Prill “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge”**

Me rastin e shënimit të 12 – Prillit, “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge” nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale në SHFMU “Martin Camaj” në Gurrakoc, është mbajtur një ligjëratë informuese më nxënës të klasave VI dhe VII.

Qëllimi i ligjëratës ishte informimi i nxënësve për parandalimin e dukurisë negative të kërkim-lëmshës nga fëmijët si dhe shkaqet dhe pasojat që krijon dhënia e lëmshës, me theks të veçantë tek fëmijët në situatë rruge.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga kjo ligjëratë janë gjithsej 28 nxënës/e prej tyre 16 M dhe 12 F.**

### **Rekomandime të dala nga ligjëratat informuese më nxënës/e:**

- Vetëdijesimi në mënyrë të vazhdueshme i fëmijëve dhe qytetarëve në përgjithësi për dukurinë negative të kërkim-lëmshës, e cila po stimulon edhe më shumë që fëmijët të vazhdojnë të dëmtojnë të ardhmen dhe të mos i gëzojnë të drejtat e tyre ashtu si gjithë fëmijët tjerë;
- Raportimi i rasteve të fëmijëve në situatë rrugë në institucionin e Qendrës për Punë Sociale dhe Polici;

## **12 Qershori “Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve”**

Në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale me rastin e shënimit të 12 Qershorit “Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve”, në FSHMU “Trepça” në Banjë, nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim janë mbajtur dy takime me nxënës/e dhe prindër me temën “Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe shfrytëzimi”.

Takimet kishin si qëllim ndërgjegjësimin e prindërve, fëmijëve, institucioneve dhe qytetarëve në përgjithësi për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda, kuptimin e punës se lejuar dhe jo të lejuar të punës së fëmijëve, format më të rënda të punës së fëmijëve, shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve, korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë, të autorizuar për të vepruar dhe bashkëpunuar në identifikimin, tërheqjen, rehabilitimin dhe ri integrimin e fëmijëve të angazhuar, procesi i menaxhimit të rasteve dhe raportimi i rasteve të fëmijëve të cilët janë të përfshirë në punë të rënda.

**Si rezultat i këtyre takimeve janë ndërgjegjësuar 38 nxënës/e prej tyre 9 M dhe 29 F, ndërsa prindër ishin prezentë 18 prej tyre 4 M dhe 14 F.**

**Rekomandime të dala nga prindërit dhe nxënësit :**

- Parandalimi dhe raportimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë, tek institucionet përkatëse;
- Takime të vazhdueshme me prindër dhe fëmijë për ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe shfrytëzimi i tyre si dhe pasojat negative të punës së fëmijëve;
- Marrja e masave të nevojshme nga institucionet përkatëse për rastet e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda;

### **“Fushata kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore – 2025”**

Në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete-Drejtoria për Administratë Komunale, nga Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim në bashkëpunim me përfaqësues nga Policia në Istog, ka mbajtur “Fushatën Vetëdijesuese kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2025” me nxënësit e klasave të VI, VII, VIII, IX.

Qëllimi i kësaj fushate ishte parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore, si një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut, si dhe rritja e vetëdijes së qytetarëve për:

- Rëndësinë e identifikimit të hershëm të viktimave potenciale të trafikimit,
- Njohjen e faktorëve dhe pasojave që çojnë në trafikim dhe,
- Inkurajimin për raportimin e rasteve pranë institucioneve përgjegjëse,

“Fushata Vetëdijesuese kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore - 2025” është mbajtur me nxënës/e të klasave VI - IX, në shkollat: FSHMU “Trepça” Banjë, FSHMU “Bajram Curri” Istog, FSHMU “Ndre Mjeda” Rakosh, FSHMU “Hysni Zajmi” Vrellë, FSHMU “Ismail Qemali” Saradran, FSHMU “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” Uçë, FSHMU “Zymer Zeka” Kaliqan, , FSHMU “Martin Camaj” Gurrakoc, SHFMU “Avni Rustemi” Zallq, dhe SHFMU “Mehmet Akif” Shushicë.

☛ **Mesazhi i fushatës: “Trafikimi prek të gjithë! Ta mbrojmë veten dhe fëmijët tanë.”**  
**Slogani: “Mos hesht!”**

**Numri i nxënësve të vetëdijësuar nga kjo fushatë është gjithësej 338 prej tyre 149 M dhe 189 F.**

### **Sesione informuese me nxënës/e me temën “Parandalimi i Bullizmit dhe Dhunës në Shkolla”**

Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale ka mbajtur sesione informuese me temën “Parandalimi i Bullizmit dhe Dhunës në Shkolla” me nxënës/e të klasave VI, VII VIII, IX në F.SH.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, F.SH.M.U “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” në Uçë dhe F.SH.M.U “Ismail Qemali” në Saradran.

Sesionet informuese me nxënës/e kishin si qëllim informimin e nxënësve për shkaqet dhe pasojat që ka bullizmi dhe dhuna në shkolla dhe rëndësi të veçantë gjatë këtyre sesioneve i është kushtuar identifikimit, parandalimit dhe raportimit të dhunës si dhe ngritja e vetëdijes për të mos e toleruar bullizmin dhe dhunën në shkolla, sepse dhuna në mjediset e shkollës në të gjitha format e saj është shkelje e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve

**Numri i nxënësve të informuar nga këto sesione është gjithsej 87 nxënës/e, prej tyre 42 M dhe 45 F.**

**Objektiva Strategjike 5:** Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre.

**Objektiva specifike 5.2:** Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve

**Rezultatet 5.2:**

**Takimi i parë i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog,** është organizuar nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale në bashkëpunim më Drejtorinë për Arsim. Qëllimi i takimit me përfaqësuesit e Asamblesë ishte Prezantimi i Raportit Vjetor 2024 i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog, në veçanti diskutimi për kërkesat dhe rekomandimet e dalura nga takimet e mbajtura gjatë vitit 2024.

**Pjesëmarrës/e në takim ishin gjithsej 20 përfaqësuese nga Asambleja prej tyre 8 M dhe 12 F.**

**Takimi i dytë i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog,** është organizuar nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale në bashkëpunim më Drejtorinë për Arsim, i cili ishte takimi i përbashkët ndërmjet përfaqësueseve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog dhe anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, me rastin e shënimit të 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Qëllimi i këtij takimi të përbashkët ishte krijimi i mundësisë së tyre që si përfaqësues të Asamblesë Komunale të Fëmijëve të ngritin çështje të rëndësishme që prekin të drejtat dhe mirëqenien e të gjithë fëmijëve, duke përfaqësuar në këtë mënyrë me dinjitet shkollat komunitetin që përfaqësojnë.

**Pjesëmarrës/e në takim ishin gjithsej 19 përfaqësuese nga Asambleja prej tyre 6 M dhe 13 F.**

**Takimi i Tretë i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog,** është organizuar nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale në bashkëpunim më Drejtorinë për Arsim.

Qëllimi i këtij takimi ishte lidhur me paraqitjen e çështjeve dhe propozimeve të ndryshme nga anëtarët e Asamblesë (sigurinë në shkolla, transporti i nxënësve, gjendja e objekteve shkollore dhe mjedisit përreth, përfshirja e nxënësve në vendimmarrje) si dhe mundësia që asamblistët t'i drejtohen me pyetje Drejtorisë Komunale të Arsimit për çështje konkrete që ju interesojnë.

**Pjesëmarrës/e në takim ishin gjithsej 12 përfaqësues/e nga Asambleja prej tyre 5 M dhe 7 F.**

## 5. Aktivitetet e realizuara nga zyrtarët e Policisë në Istog:

**Objektiva Strategjike 1:** Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë

**Objektiva specifike 1.9:** Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit

**Rezultatet 1.9:**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog është ligjëruar tema: “Pasojat e përdorimit të narkotikëve” me nxënës të shkollave nga SHFMU “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” në Uçë, FSHMU “Hysni Zajmi” në Vrellë, FSHMU “Mehmet Akif” në Shushicë, FSHMU “Martin Camaj” në Gurrakoc, SHFMU “Zymer Zeka” në Kaliqan dhe FSHMU “Ani Rrustemi” në Zallq.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 175 nxënës/e**

**Objektiva Strategjike 2:** Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

**Objektiva specifike 2.2** Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët

**Rezultatet 2.2:**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog është ligjëruar tema: “Bullizmi dhe masat parandaluese” me nxënës të shkollave nga SHFMU “Trepça” në Banjë, FSHMU “Martin Camaj” në Gurrakoc, FSHMU “Bajram Curri” në Istog, FSHMU “Avni Rrustemi” në Zallq, SHFMU “Ismaili Qemali” në Saradran, FSHMU “Zymer Zeka” në Kaliqan dhe FSHMU “Ndre Mjeda” në Rakosh.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 253 nxënës/e**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog është ligjëruar tema: “Dhuna në familje dhe dhuna ndaj fëmijëve” me nxënës të shkollës nga SHFMU “Bajram Curri” në Istog dhe temat “Narkotikët” dhe “Ngacmimet Seksuale” IAAP “Mithat Frashëri” në Gurrakoc.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 73 nxënës/e**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog në 6 shkolla është ligjëruar tema: “Parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe masat ligjore ndëshkimore”.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 199 nxënës/e**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog në 8 shkolla është ligjëruar tema: “Shumëllojshmëria si vlerë shoqërore”.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 263 nxënës/e**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog në 8 shkolla është ligjëruar tema: “Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të internetit”.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 257 nxënës/e**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog në 8 shkolla është ligjëruar tema “Familjet e lumtura”.

**Si rezultat të vetëdijesuar nga këto ligjërata janë gjithsej 153 nxënës/e**

**Objektiva Strategjike 3:** Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët

**Objektiva specifike 3.1:** Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

**Rezultatet: 3.1:**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog është ligjëruar tema: “Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik” me nxënës të shkollave nga FSHMU “Hysni Zajmi” në Sudenicë dhe Prigodë, SHFMU “Bajram Curri” në Istog, FSHMU “Ndre Mjeda” në Rakosh, FSHMU “Martin Camaj” në Gurrakoc dhe “Avni Rustemi” në Zallq.  
**Si rezultat të informuar nga këto ligjërata janë gjithsej 238 nxënës/e**
- Zbatimi i Planit Operativ “Kontrollimi i shtuar i transportit publik të udhëtarëve/nxënësve” ku nga ana e policisë janë kontrolluar 8 mjete të transportit të nxënësve dhe janë kontrolluar 196 nxënës. Nuk është hasur asgjë e dyshimtë.
- KFOR-i Italian në bashkëpunim me DKA-në Istog, në Stadiumin “Demush Mavraj” në Istog ka organizuar një aktivitet jashtë kurrikularë (rekreativo-sportiv), ku kanë marrë pjesë nxënësit e klasave të V (pesta) të shkollave fillore në nivel komunal, ku Njësia e Sektorëve ka bërë sigurimin për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti.
- Me kërkesë të Drejtorisë së SHMUF “Martin Camaj” në Gurrakoc, është asistuar stafi i shkollës në mbarëvajtjen e një aktiviteti sportiv (kros). Aktiviteti është zhvilluar në Rr. 7 Marsi, ku nxënësit e kësaj shkollë kanë vrapuar, në distanca të ndryshme në këtë rrugë, deri në cak final në oborrin e shkollës. Patrulla e sektorit është përkujdesur për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti, duke ndaluar qarkullimin e automjeteve në kohën sa ishte duke u zhvilluar ky aktivitet.
- Me rastin e festës së 1 Qershorit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me OJQ “Folklori i Podgurit Istog”, kanë organizuar një koncerti për fëmijë në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari” në Istog. Në këtë manifestim kanë marrë pjesë rreth 450 fëmijë (kryesisht nxënës të SHFMU “Bajram Curri” – Istog). Patrulla e Sektorit dhe Njësitë e tjera të Stacionit Policor në Istog, kanë qenë të angazhuar në rregullimin e trafikut dhe sigurimin e lëvizjes së nxënësve nga objekti shkollës deri në shtëpinë e kulturës dhe anasjelltas.

**Objektiva Strategjike 4:** Zhvillimi i fëmijëve përmes sportit, lojës dhe rekreacionit

**Objektiva specifike 4.5:** Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin


**Rezultatet: 4.5:**

- Nga zyrtarë të Policisë në Istog është ligjëruar tema: “Ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore” me nxënës të shkollave nga FSHMU “Zymer Zeka” në Kaliqan, FSHMU “Hysni Zajmi” në Vrellë, FSHMU “Martin Camaj” në Gurrakoc, “Avni Rustemi” në Zallq, FSHMU “Trepça” në Banjë, FSHMU “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” në Uçë dhe FSHMU “Mehmet Akif” në Shushicë.  
**Si rezultat të informuar nga këto ligjërata janë gjithsej 212 nxënës/e**

**Sfidat e Raportimit të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës Istog (2024 - 2026):**

- Sfida teknike dhe metodologjike për shkak që disa të dhëna nuk janë raportuar dhe sistemuar sipas indikatorëve specifik ashtu siç kërkohet në këtë Plan;
- Të dhënat nuk konsiderohen të jenë shumë të plota dhe të harmonizuara;
- Mungesa e një Ekipi të trajnuar për monitorim dhe raportim sepse jo të gjithë anëtarët e Ekipit e kanë përvojën ose njohuritë që të analizojnë dhe të interpretojnë të dhënat në mënyrën e duhur;

Sekretare e Ekipit  
Zyrtare për Mbrojtje  
të Fëmijëve dhe Riintegrim  
znj. Vlora Gjoci

  
\_\_\_\_\_

Kryesues i Ekipit për të Drejtat Fëmijës  
Kryetari i Komunës  
/z. Ilir FERATI





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosova



Komuna e Istogut

Opština Istok

Municipality of Istog

<b>Data/Date:</b>	10/02/2026
<b>Nga/Od/From</b>	Ilir Ferati, Kryetar i Komunës së Istogut
<b>Për/Za/To:</b>	Enver Rugova, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Istogut
<b>Përmes/Preko/Through</b>	Jeta Balaj Imeraj Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun
<b>Tema/Subjekat/Subject</b>	Raport: Realizimi i Planit të Veprimit për Transparencë komunale gjatë vitit 2025

Më 31 Janar 2023, në seancë të rregullt të kuvendit të komunës, është marrë vendimi për miratimin e PVT-së, për vitet 2023-2026.

Në këtë raport janë të përfshira të gjitha aktivitetet me impakt publik e zyrtar që janë realizuar gjatë vitit 2025.

#### **Mbledhjet rregullta, të jashtëzakonshme dhe solemne të KK-së:**

1. Gjatë gjithë vitit 2025, me kohë janë publikuar njoftimet dhe materialet përcjellëse (projekt dokumentet, shkresat,) etj., për mbledhjet e rregullta, të jashtëzakonshme dhe mbledhjeve solemne. Njoftimet në afate ligjore janë bërë edhe për Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe komitetet tjera, trupa këshillues dhe profesional të KK-së. Gjatë këtij viti janë mbajtur gjithsej **13** mbledhje të kuvendit.  
**9** të mbledhje të rregullta,  
**3** solemne dhe  
**1** inauguruese .

Të gjitha mbledhjet e KK-së, janë transmetuar drejtpërdrejt në TV-nw ,lokale dhe videot janë publikuar në Ueb faqe të komunës sonë.

### **Konsultimet publike:**

1. Me kohë janë publikuar njoftimet, materialet, procesverbalet dhe raportet për mbajtjen e konsultimeve publike për të gjitha dokumentet të cilat, kryetari, kuvendi dhe dikasteret tjerë në komunë, kanë sponsoruar për hartim dhe miratim. Gjatë vitit 2025, janë mbajtur 15 konsultime publike, duke përfshirë edhe dëgjimet buxhetore: Njoftimet, raportet dhe procesverbalet janë publikuar në ueb faqe të komunës dhe si dhe në vegëzen e Qeverisë së Republikës së Kosovës:

<https://istog.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

### **Takimet publike:**

2. Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, gjatë vitit 2025, ka mbajtur 2 takim publik, ku ka raportuar për punën e tij gjashtë mujore dhe në dhjetor pritet ta mbajt takimin e dytë për punën një vjeçare. Për takimin e parë është mbajtur procesverbal dhe raport me shkrim, dokumentet janë publikuar me kohë në ueb faqe dhe gjithashtu takimet janë transmetuar edhe drejtpërdrejt, në kohë reale nga operatori ekonomik me të cilin ka kontratë komuna jonë, edhe për të dytin pasi të përfundojë takimi do të publikohen të gjitha dokumentet e kërkuara.

32.0

### **Takimet dhe intervistat me gazetar, qytetarë dhe OJQ-ë:**

3. Gjatë gjithë vitit janë dhënë intervista për televizione nacionale e lokale, po ashtu kemi mbajtur komunikime zyrtare edhe me portale të ndryshme, u jemi përgjigje gazetarëve, qytetarëve dhe OJQ-ve, në të gjitha pyetjet e tyre. Kemi plotësuar raporte të ndryshme për OJQ-të, si: KDI-i dhe GAP-i. Kërkesë për plotësim të raporteve me të dhëna zyrtare kemi pasur edhe nga MAPL-ë. Përgjigjet dhe plotësimi i raporteve është dhënë konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Takime me qytetarë kryetari i komunës, Ilir Ferati, mbanë çdo të enjte në zyrën e tij.**

### **Qasja në dokumente zyrtare/publike:**

4. Në vazhdimësi janë pranuar kërkesa për qasje në dokumente zyrtare/publike, gjatë gjithë vitit 2025.

Kërkesa të pranuar 17 ku është dhënë qasje e plotë

Raporti me të gjitha detajet është i publikuar në këtë vegëz: <https://istog.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/20260203130043936-1.pdf> , i njëjti është dërguar brenda afatit ligjor edhe në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

### **Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativa qytetare dhe peticione:**

5. Gjatë vitit 2025, nuk kemi pasur asnjë iniciativë qytetare apo peticion.

### **Publikimi i akteve komunale:**

6. Vendimet e Kuvendit dhe vendimet e nënshkruara nga Kryetari i komunës janë publikuar në ueb-faqe si dhe me kohë janë dërguar në MAPL-ë, për konfirmim ligjor. Janë publikuar edhe rregulloret, planet dhe strategjitë e ndryshme që ka hartuar komuna.
  - 6.1 Vendimet e Kuvendit janë publikuar në këtë vegëz:  
<https://istog.rks-gov.net/vendimet-e-kuvendit/>
  - 6.2 Vendimet e Kryetarit janë publikuar në këtë vegëz:  
<https://istog.rks-gov.net/vendimet-e-kryetarit/>
  - 6.3 Në vazhdimësi janë publikuar më kohë dokumentet që ka hartuar dhe miratuar kryetari dhe kuvendi si: vendimet, rregulloret, strategjitë dhe plane të ndryshme:
  - 6.4 Rregulloret janë publikuar në këtë vegëz:  
<https://istog.rks-gov.net/rregulloret/>
  - 6.5 Planet janë publikuar në këtë vegëz:  
<https://istog.rks-gov.net/strategjite-komunale/>

### **Përditësimi i ueb-faqes zyrtare të Komunës:**

7. Në vazhdimësi është përditësuar ueb-faqja me lajme, njoftime, komunikata, fotografi, video etj..., gjithashtu janë bërë edhe ndryshimet e nevojshme me qëllimin që t'u lehtësohet palëve të treta, qasja sa më e lehtë, në të dhënat të cilët prodhohen nga kryetari, kuvendi, kryesuesja, drejtorët si dhe zyrtarët tjerë komunal.

### **Pika prokurimi transparentë:**

8. Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me prokurimin publik, janë të publikuara më kohë, dokumentet janë të publikuara në këtë vegëz:  
<https://istog.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate/>

### **Procedurat e punësimit transparent për qytetarë:**

